



Buletini

- * Aktivitetet nga Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm (PTV)
- * Aktivitetet nga Programi i Trajnimit Fillestar (PTF)
 - * Aktivitetet nga Programi për Hulumtime dhe Publikime
- * Aktivitetet profesionale të tjera të lira
 - * Aktivitetet tjera

Shtator 2019

Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve të Vazhdueshme

Mjetet e rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike

Më 3 shtator 2019, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme (PTV), realizoi trajnimin me temë “Mjetet e rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike”.



Qëllimi i këtij trajnimi ishte që përfituesit ti avancojnë njohuritë e tyre lidhur me mjetet e rregullta dhe të jashtëzakonshëm juridike.

Fillimisht trajnimi u fokusua në fazat procedurës penale sipas Kodit të Procedurës Penale e më pastaj te llojet e mjeteve juridike në

dispozicion, për atakimin e aktgjyqimeve të gjykatës themelore në gjykatën e Apelit.

Trajnimi u shoqërua me bashkëbisedime për praktikatat e gjykatave dhe prokurorive dhe mundësitë e përmirësimit në kuptimin e bashkëpunimit ndërinstytucional duke përfshirë gjykatën, prokurorinë dhe Policinë e Kosovës.

Pjesa e dytë e trajnimit iu kushtua mjeteve të jashtëzakonshme juridike në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe mbuloi aspektet si: palët që mund të ushtrojnë kërkesa për mjetet juridike, kërkesat ligjore për parashtrimin e ankesave, kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë, shkeljet esenciale që duhet pasur parasysh gjatë trajtimit të kërkesave, çështja e juridiksionit, situatat kur aktgjykimi e tejkalon aktakuzën dhe të ngjashme.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë, prokurorë dhe zyrtar ligjor nga niveli themelor.



Programi i Hetimeve Financiare– Trajnimi 1

Më 3-6 shtator 2019, Akademia e Drejtësisë në kuadër të PTV, në bashkëpunim me UNODC-in, ka realizuar trajnimin me temë “Programi i Hetimeve Financiare– Trajnimi 1”.



Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive rreth bashkëpunimit ndërkombëtar në hetimin sa më suksesshëm, grumbullim e provave dhe çështjeve problematike të cilat shfaqen në praktikë me rastin e hetimit dhe gjykimit të pastrimit të parave dhe veprave penale që ndërlidhen me të.

Gjatë trajnimit u trajtuan hetimet financiare, mjetet dhe teknikat për analizën e të dhënave të shumta, detyrat dhe mjetet e përpunimit të të

dhënave që kanë të bëjnë me burimet e informacionit. Po ashtu, mbledhjen, përpunimin dhe analizimin e të dhënave financiare me qëllim që ato të dhëna financiare të kualifikohen si prova. Vëmendje i'u kushtua paraprakisht hetimit të skemave në shkallë të gjerë të pastrimit të parave, krimeve tatimore dhe doganore duke përfshirë bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar që në praktikë është mëse i nevojshëm për t'i hetuar dhe gjykuar këto vepra penale të cilat përbëjnë rrezik për zhvillimin ekonomik të një vendi.

Me rastin e këtij trajnimi përmes punës në grupe janë adresuar gjitha çështjet problematike duke zbërthyer dispozitat ligjore që e rregullojnë këtë fushë si dhe duke shkëmbyer praktikat më të mira në këtë drejtim.

Përfitues të këtij trajnimi janë: gjyqtarë, prokurorë, zyrtarë nga NJIF, Policia e Kosovës, staf administrativ - ekspert të fushës nga SKPK.



Ligji për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar

Më 04 shtator 2019, Akademia e Drejtësisë organizoj trajnimin me temë: “Ligji për tatimin mbi vlerën e shtuar” në kuadër të PTV-së.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve lidhur me aplikimin dhe zbatimin e TVSH-së në Republikën e Kosovës dhe në rajon.

Në pjesën e parë të trajnimit u trajtuan: Aplikimi i TVSH-së në Republikën e Kosovës dhe në rajon - kushtet e regjistrimit për TVSH dhe normat e TVSH-së. Në pjesën e dytë u zbërthyen dispozitat ligjore që përmban Ligji për tatimin mbi vlerën e shtuar duke shpjeguar kriteret lidhur me ciklin e procesit të TVSH nga Dogana e deri te pagesa e konsumatorit të fundit, dhe praktikrat e TVSH-së në vendet e rajonit. Po ashtu, u trajtuan raste të ndryshme nga praktika gjyqësore dhe praktika e vendeve tjera me të cilat Republika e Kosovës ka më shumë eksport-importe ku u shpjegua se si definohehen të drejtat dhe obligimet e TVSH-së që paguhen në Doganën e Kosovës dhe në Administratën Tatimore të Kosovës.

Me rastin e trajtimit të kësaj materie u potencua se në praktikë shpeshherë ka probleme rreth çështjes së aplikimit të TVSH-së dhe në vlerësimin e tyre konform peshës së tyre si dhe dilema ligjore. Vëmendje të veçantë i ‘u kushtua ndryshimeve të vazhdueshme në legjislacionin tatimor që ka të bëjë me tatimin mbi vlerën e shtuar me qëllim të harmonizimit me Direktivat

e BE-së, si në Ligji bazik 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat dhe Ligji 05/L-037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar. Sa i përket kompetencës për vendosje u potencua se Divizioni Fiskal i Departamentit për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore në Prishtinë është përgjegjës për të gjykuar në shkallë të parë çdo vendim nga Departamenti i Ankesave në lidhje me taksat, detyrimet doganore dhe çdo kontribut tjetër të caktuar nga legjislacioni në fuqi. Juridiksioni i ankesave të Divizionit Fiskal, i mbulon tatimet dhe detyrimet si: tatimin mbi të ardhurat personale; tatimin mbi të ardhurat e korporatave; Ligjin e TVSH-së; detyrimet doganore; detyrimet e akcizës; tatimi mbi pronën e paluajtshme dhe çdo tatim ose kontribut tjetër të aplikuar në Kosovë.

Gjatë këtij trajnimi u përdoren metodat e shpjegimit të pjesshëm teorik, duke u bazuar në raste nga praktika gjyqësore duke u shoqëruar me ushtrime, diskutime interaktive, materialit të ofruar nga trajnuesit, analizës së rasteve studimore si dhe duke zbërthyer dispozitat ligjore në fuqi që rregullojnë këtë lëmi.

Përfitues në këtë trajnim ishin gjyqtarët e Departamentit për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore dhe Gjykatës së Apelit si dhe bashkëpunëtorët profesional të Departamentit për Çështje Administrative – Divizioni Fiskal dhe Departamentit Ekonomik.



Mbrojtja gjyqësore në kontestet nga marrëdhënia e punës sipas Ligjit të Punës

Më 05 shtator 2019, Akademia e Drejtësisë organizoj trajnimin me temë: “Mbrojtja gjyqësore në kontestet nga marrëdhënia e punës sipas Ligjit të Punës” në kuadër të PTV-së.



Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve lidhur me kontestet nga marrëdhënia e punës sipas legjislacionit në fuqi të punës në Republikën e Kosovës.

Në pjesën e parë të trajnimit u trajtuan: Kontratat e punës dhe llojet e tyre dhe kontestet nga marrëdhënia e punës sipas ligjit të punës. Ndërsa në pjesën e dytë u trajtuan: Procedura gjyqësore për mbrojtjen e të drejtave të punës dhe respektimi i afateve për të kërkuar mbrojtje gjyqësore.

Në fillim të trajnimit u potencua se në vitet e fundit është rritur numri i kontesteve nga marrëdhënia e punës. Shkak për këtë është se legjislacioni në fuqi ka pasur mangësi dhe mbrojtja gjyqësore nuk ka qenë adekuate me ç’rast shpesh është cënuar e drejta e punëtorit nga marrëdhënia e punës. Si rrjedhojë, dispozitat të cilat e kanë rregulluar këtë fushë kanë qenë të shpërndara në shumë ligje dhe rregullore, të cilat janë nxjerr dhe miratuar në rrethana të ndryshme ekonomike, shoqërore dhe politike. Si rezultat i kësaj gjyqtarët kanë pasur dhe kanë vështirësi në zbatimin adekuat të këtyre ligjeve, të cilat i referohen mbrojtjes së të drejtave të punëtorëve që rrjedhin nga marrëdhënia e punës.

Në vazhdim u analizua dhe u zbërthye procedura e filluar nga punëmarrësit në rastet e shkeljeve të detyrave të punës nga ana e punëdhënësve, përfshirë këtu edhe identifikimin e kushteve paraprake të cilat duhet të plotësohen nga kërkuesi para se t’i drejtohet gjykatës me padi për të siguruar mbrojtje gjyqësore në rastet kur i drejtohet gjykatës me padi.

Më tej u trajtuan edhe shkaqet e shkëputjes së kontratës së punës, llojet e vendimeve gjyqësore që merren tek kontestet e punës, dallimet në mes të kontesteve për shërbyesit civil dhe kontesteve tjera nga marrëdhënia e punës, kompetenca, afatet, mjetet juridike, respektimi i afateve për të kërkuar mbrojtje gjyqësore, më saktësisht çështja e shterimit të mjeteve të brendshme juridike për të fituar te drejtën e kërkimit të mbrojtjes gjyqësore, si dhe pasojat juridike të mos respektimit të afateve për të kërkuar mbrojtje gjyqësore sipas legjislacionit në fuqi tek kontestet e punës.

Gjithashtu u konkludua se procedura për mbrojtjen gjyqësore të të drejtave që rrjedhin nga marrëdhënia e punës është e veçantë për të cilën përveç zbatimit të rregullave të përgjithshme të procedurës kontestimore zbatohen edhe disa rregulla të veçanta që janë paraparë me nenet 474 deri në 477 të LPK-së.

Gjatë këtij trajnimi u përdoren metodat e shpjegimit të pjesshëm teorik, duke u bazuar në raste nga praktika gjyqësore duke u shoqëruar me ushtrime, diskutime interaktive, materialit të ofruar nga trajnuesit, analizës së rasteve nga praktika e pasur gjyqësore si dhe duke zbërthyer dispozitat ligjore në fuqi që rregullojnë këtë lëmi.

Përfitues në këtë trajnim ishin gjyqtarët e gjykatave themelore dhe të Gjykatës së Apelit si dhe bashkëpunëtorët profesional të gjykatave.

Masat mbrojtëse për viktimat e mitur dhe dëshmitarët e veprave penale

Më 9 shtator 2019, Akademia e Drejtësisë në kuadër të PTV, me mbështetjen e UNICEF-it ka realizuar trajnimin për gjyqtarë dhe prokurorë me temë: “Masat mbrojtëse për viktimat e mitur dhe dëshmitarët e veprave penale”.



Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve që përmes diskutimeve dhe prezantimit të praktikave më të mira, si dhe përmes elaborimit të rasteve nga praktika të zbatohen drejtë masat mbrojtëse për viktimat e mitur dhe dëshmitarët e veprave penale në mënyrë që të respektohet denjësisht personaliteti dhe dinjteti i tyre.

Me rastin e këtij trajnimi u trajtuan çështjet që kanë të bëjnë me definimin e viktimave dhe dëshmitarëve të mitur (fëmijë, të mitur, madhorë të rinj) të cilët kanë qenë viktimë e krimit nga vepra penale me theks të veçantë të veprave penale kundër integritetit seksual. Vëmendje gjatë këtij trajnimi iu kushtua teknikave dhe taktikave të marrjes në pyetje të këtyre viktimave të ndjeshme, duke mos përjashtuar edhe marrjen në pyetje nëpërmjet video-konferencës dhe të dhomës së dëshmitarëve. Paraprakisht u trajtuan edhe të drejtat e këtyre viktimave, shoqërimi psiko-social në proces, strukturat e ndihmës për këto viktima si dhe e drejta e tyre për kompensim, respektimi i rregullave procedurale për përjashtimin e publikut në mënyrë që këto viktima mos të ri viktimizohen prapë.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë, gjyqtar nga departamenti i përgjithshëm, prokurorë për të mitur të nivelit themelor.



Masat për sigurinë e pranisë së të miturit në procedurë penale

Më 10 shtator 2019, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit të Trajnimit të Vazhdueshëm, ka realizuar trajnimin me temë “Masat për sigurinë e pranisë së të miturit në procedurë penale”

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve që përmes diskutimeve dhe prezantimit të praktikave më të mira, si dhe elaborimit të rasteve nga praktika të zbatohen drejtë dispozitat ligjore që rregullojnë këtë fushë si dhe masat edukative dhe dënimet për të mitur.

Me rastin e këtij trajnimi u potencua që ndaj të miturit i cili ka ra ndesh me ligjin mund të urdhërohet arresti i përkohshëm, ndalimi policor dhe paraburgimi vetëm si masë e fundit për një

kohë sa më të shkurtër. Gjithashtu vu në pah se në praktikë ndodhin raste që në procedurën ndaj të miturve paraburgimi si masë e fundit nuk është caktuar sipas mënyrës dhe kushteve të parapara nga KDM. Vëmendje iu kushtua rasteve, kur prokurori për të mitur i propozon gjykatës caktimin e masës së paraburgimit për të miturin, duke përfshirë kushtet ligjore që duhet plotësuar në rastet e caktimit të këtyre masave. Prandaj nga diskutimet e përbashkëta ofruan zgjidhjet më të mira dhe në pajtim me dispozitat ligjore të cilat e rregullojnë këtë fushë.

Përfitues në këtë trajnim ishin: gjyqtarë dhe prokurorë nga Departamenti për të Mitur nga regjione të ndryshme të Kosovës.



Kontrata e ndërtimit

Më 11 shtator 2019, Akademia e Drejtësisë organizoj trajnimin me temë: “Kontrata e ndërtimit” në kuadër të PTV-së.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve në zbatimin dhe interpretimin e dispozitave kontraktuese, për zgjidhjen e kontesteve që lindin nga raporti afarist i krijuar, përmes këtyre kontratave dhe i praktikës gjyqësore në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe evropiane.

Në pjesën e parë të trajnimit u trajtuan: Kuptimi i kontratës mbi ndërtimin dhe kontratës për inxhinieringun dhe specifikat e tyre, karakteristikat e kontratës publike të ndërtimit, kushtet e përgjithshme dhe kushtet e veçanta të kontratës, klauzola “çelësi në dorë”, ndryshimet e çmimeve për shkak të ndryshimeve në treg dhe procedurat ligjore në mbrojtjen e të drejtave të palëve afariste në kontestet që rrjedhin nga mos përmbushja e këtyre kontratave.

Ndërsa në pjesën e dytë u zbërthyen mënyrat dhe kriteret e vlerësimit të elementeve specifike në rastet e pretendimeve për mos përmbushje apo kontestimin e vlefshmërisë së këtyre kontratave.

Me rastin e këtij trajnimi u theksua se kontratat mbi ndërtimin dhe kontratat për zhvillimin e projekteve ndërtimore (inxhinjeringu) aktualisht kanë gjetur përdorim shumë të madh në fushën e ndërtimit duke pasur parasysh fazën e rindërtimit të vendit. Po ashtu kontratat e ndërtimit në sektorin publik kanë një përdorim të gjerë. Shoqëritë tregtare gjatë zhvillimit të biznesit në sferën ndërkombëtare shpesh aplikojnë kontratat për të cilat zbatohet Konventa për shitje ndërkombëtare të mallrave, ndërsa në praktikën gjyqësore u potencua me tej se numri i kontesteve që rrjedhin nga këto kontrata është i konsiderueshëm, me tendencë të rritjes.

Gjatë këtij trajnimi u analizuan raste nga praktika gjyqësore dhe pati diskutime interaktive, duke zbërthyer dispozitat ligjore në fuqi që rregullojnë këtë lëmi.

Përfitues në këtë trajnim ishin gjyqtarët e Departamentit për Çështje Ekonomike dhe Administrative të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Gjykatës së Apelit si dhe gjyqtarët e departamenteve të përgjithshme – divizionet civile të gjykatave themelore.



Program i Specializuar trajnimi për Prokurimin Publik të Kosovës-Sesioni II

Më 12-13 shtator 2019, Akademia e Drejtësisë, në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, realizoi trajnimin dy ditor me temën “Program i Specializuar - Trajnimi për Prokurimin Publik të Kosovës – Sesioni II” .

Qëllimi i këtij trajnim avancimi njohurive të pjesëmarrësve rreth implementimit të kontratës, hetimit dhe gjyqimit të veprave penale të kësaj natyre.

Gjatë këtij trajnimi u trajtuan: faza e implementimit të kontratës, vlerësimi i nevojave/përcaktimi i kërkesave, përgatitja/procesi i dizajnit dhe përgatitja dokumenteve të ofertimit, zgjedhja e kontraktorit dhe faza e dhënies së çmimit. Me theks të veçantë u

theksuan skemat korruptive dhe problemet e ndërlidhura me mashtrim, si të bëhet planifikimi i hetimit dhe ndjekja.

Po ashtu u trajtuan edhe pagesa e haraçit, konflikti i interesit, skemat e kurdisjes së ofertave, ofertomi konspirativ, skemat mashtruese, përmbajtja e planit të hetimit, identifikimi i burimeve të informacionit, planifikimi i kontrollit të shtëpisë dhe përgjimi, planifikimi i përdorimit të informatorëve si dhe planifikimi i gjurmimit të aseteve.

Përfitues të këtij sesioni trajnues ishin gjyqtarë dhe prokurorë të nivelit themelore nga regionet të ndryshme të Kosovës.



Shqyrtimi Fillestar dhe Shqyrtimi i Dytë

Më 17 shtator 2019, Akademia e Drejtësisë, në kuadër të Programit të Trajnimit të Vazhdueshëm, ka realizuar trajnimin me temë “Shqyrtimi Fillestar dhe Shqyrtimi i Dytë”.

Qëllimi i trajnimit ishte avancimi i njohurive profesionale të përfituesve në zbatimin e drejtë të procedurave specifike tek rastet kur kemi të bëjmë me shqyrtimin fillestar dhe shqyrtimin e dytë në funksion të zbatimit efikas të procedurës penale.

Në kuadër të këtij trajnimi u trajtua shqyrtimi fillestar dhe shqyrtimi i dytë, afatet e caktimit të shqyrtimit fillestar pas pranimit të aktakuzës dhe shqyrtimit të dytë, veprimet e kryetarit të trupit gjykues apo gjyqtarit të vetëm gjykues dhe rrjedha e shqyrtimit fillestar dhe shqyrtimit të dytë.

Paraprakisht, u elaboruan kriteret me rastin e

pranimit të fajësisë, opsionet pas pranimit të fajësisë dhe rastet e veçimit të procedurës kur ka më shumë të pandehur dhe disa prej tyre e pranojnë fajësinë në shqyrtimin fillestar e disa të tjerë jo. Më tej u sqarua se gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues, siguron që prokurori i shtetit të ketë përmbushur detyrimet që kanë të bëjnë me zbulimin e provave përkatësisht njofton të pandehurin dhe mbrojtësin e tij se para shqyrtimit të dytë duhet të paraqesin kundërshtimet e tyre për provat e cekura në aktakuzë, të paraqesin kërkesat për hedhjen e aktakuzës nëse është e ndalur ligjërisht të paraqesin kërkesat për hudhjen e aktakuzës për shkak të mospërshkrimit të veprës penale sipas ligjit.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë, prokurorë dhe bashkëpunetore profesional nga të gjitha regjionet e Kosovës.



Shkrimi dhe arsyetimi ligjor në lëmine civile

Më 17-18 shtator 2019, Akademia e Drejtësisë me përkrahjen e USAID-it organizoj trajnimin me temë: “Shkrimi dhe arsyetimi ligjor”. Ligjërues në këtë trajnim përveç trajnuesve vendor ishte edhe gjyqtari z. Russell F. Canan,



ekspert nga USAID-i.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve në lëmin e shkrimit dhe arsyetimit ligjor nëpërmes zbatimit të standardeve bashkëkohore në këtë fushë.

Në ditën e parë të trajnimit u trajtuan: Hartimi paraprak, organizimi dhe lista e kontrollit dhe çelësi për aktgjykimet e shëndosha me shkrim dhe me gojë, metoda IRAC e të shkruarit ligjor dhe aplikimi praktik i saj dhe Pranimi i parashtrësës dhe vlerësimi formal i lejueshmërisë së procesit gjyqësor dhe shkathtësitë e shkrimit dhe arsyetimit ligjor për gjyqtarë.

Në ditën e dytë u trajtuan: Struktura dhe përmbajtja e vendimeve gjyqësore sipas dispozitave të LPK-së dhe Arsyetimi i vendimeve gjyqësore (analizë e konstatimit të fakteve, vlerësimit të provave dhe zbatimit të normës juridike).

Shkrimi dhe arsyetimi ligjor është pjesë e punës së përditshme për secilin gjyqtarë dhe zyrtarë të gjykatave dhe prokurorive, prandaj është edhe

parakusht për ngritjen e cilësisë së vendimeve gjyqësore dhe akteve të tjera, e rrjedhimisht edhe parakusht për efikasitetin dhe besueshmërinë e publikut në vendimet gjyqësore.

Pas një shqyrtimi të gjithanshëm për metodën ÇRAK-IRAC-anglisht (Çështja, Rregulli, Analiza dhe Konkluzioni) u potencua se përbëhet prej elementeve themelore të përmendura të analizës ligjore. Është proces nëpërmjet të cilit të gjithë gjyqtarët dhe juristët mendojnë rreth çdo problemi ligjor. Nëpërmjet zbatimit të kësaj formule reduktohet kompleksiteti i ligjit në një ekuacion të thjeshtë. Kjo metodë është e dobishme sepse i jep lexuesit të aktgjykimit një kuptim fillestar të çështjes, dhe e tregon rrugëtimin e ndjekur për analizën e bërë nga gjykata.

Në këtë trajnim u potencua se shkrimi i mirë ligjor karakterizohet me saktësinë, karakterin analitik, organizimin e mirë, me plotënin, konkretësinë, logjikën, korrektësinë, arsyetimin bindës dhe qartësinë.

Gjatë këtij trajnimi u përdoren metodat e shpjegimit teorik, duke u bazuar në raste studimore dhe nga praktika duke u shoqëruar me diskutime interaktive të lehtësuara nga trajnuesit, përmes analizës dhe shtjellimeve të tematikës, me fokus në zbatimin e parimeve dhe shkathtësive të shkrimit ligjor, metodës ÇRAK (IRAC) të të shkruarit ligjor dhe teknikave të hulumtimit ligjor si dhe përmes detyrave dhe rasteve praktike.

Përfitues në këtë trajnim ishin gjyqtarët dhe bashkëpunëtorët profesional e të gjitha niveleve në Republikën e Kosovës

Kompetencat e DHPGJS dhe AKP-së, parashtruesit dhe palët kundërshtare para DHPGJS, Procedura me shkrim dhe ajo verbale para Dhomës së Posaçme si dhe procedura gjyqësore për kundërshtimin e vendimeve të Agjencisë që krijohen nga procesi i Privatizimit dhe i Likuidimit

Më 18 Shtator 2019, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme (PTV), ka realizuar trajnimin me temë “ Kompetencat e DHPGJS dhe AKP-së, parashtruesit dhe palët kundërshtare para DHPGJS, procedura me shkrim dhe ajo verbale para Dhomës së Posaçme si dhe procedura gjyqësore për kundërshtimin e vendimeve të Agjencisë që krijohen nga procesi i Privatizimit dhe i Likuidimit ”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve lidhur me Juridiksionin dhe kompetencat e Dhomës së Posaçme për zbatimin e drejtë të procedurës së privatizimit dhe likuidimit.

Në pjesën e parë të trajnimit u trajtuan: Kompetencat e Dhomës së Posaçme dhe Agjencisë Kosovare të Privatizimit, kompetenca funksionale me fokus në Dhomën e Posaçme, zbatimi i vendimeve gjyqësore të viteve 1990-

1999, nga AKP.

Me rastin e këtij trajnimi u potencua si zhvillohet procedura në Dhomë të Posaçme, çka duhet të përmbaj një kërkesë, cilat janë pasojat e palëve nëse ato nuk u përmbahen rregullave për paraqitjen e provave. Në vazhdim u theksua si bëhet paraqitja e kërkesave/ankesave kreditore dhe pronësore në Komisionin e Likuidimit dhe në Dhomën e Posaçme, kundërshtimi vendimeve të Agjencisë në Dhomën e Posaçme dhe procedura e shqyrtimit të këtyre vendimeve.

Gjatë këtij trajnimi u përdoren metodat e shpjegimit të pjesshëm teorik, duke u bazuar në raste nga praktika gjyqësore duke u shoqëruar me ushtrime dhe diskutime interaktive.

Përfitues të këtij trajnimi ishin: Gjyqtarët dhe zyrtarët ligjor nga niveli Themelor dhe Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës.



Shkrimi dhe Arsyetimi Ligjor nga lemia penale

Më 19-20 shtator 2019, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, në bashkëpunim me Programin e USAID për Fuqizimin e Sektorit të Drejtësisë në Kosovë – JSSP, ka realizuar trajnimin me temë “Shkrimi dhe arsyetimi ligjor në lëmin penale”.



Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive profesionale të gjyqtarëve dhe bashkëpunëtorëve profesional në implementimin e drejtë të metodave bashkëkohore të hartimit, shkrimit dhe arsyetimit ligjor.

Në kuadër të këtij trajnimi u elaboruan çështjet rreth aplikimit të metodës IRAC si dhe aplikimit praktik të tij në vendimet gjyqësore. Vëmendje parësore iu kushtua ngritjes së shkathësive në shkrimin dhe arsyetimin e vendimeve gjyqësore (analizë e konstatimit të fakteve, vlerësimit të provave dhe zbatimit të normës juridike-shembuj). Paraprakisht, u trajtuan edhe zbatimi konsekuent i dispozitave ligjore që duhet të aplikuar kur do të hartohet një vendim gjyqësor.

Metodologjia e aplikuar ishte e kombinuar, me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive si dhe puna në grupe e pjesëmarrësve.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë dhe bashkëpunëtor profesional nga Gjykata Themelore e Prishtinës dhe Gjykata Themelore e Mitrovicës.



Shpërblimi i dëmit material dhe jo material dhe praktika gjyqësore

Më 19 shtator 2019, Akademia e Drejtësisë me përkrahjen e GIZ-it organizoj trajnimin me temë: “Shpërblimi i dëmit material dhe jo material dhe praktika gjyqësore” në kuadër të PTV-së.



Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve lidhur me shpërblimin e dëmit material dhe jomaterial dhe trajtimi i praktikës gjyqësore në këtë lëmi.

Në pjesën e parë të trajnimit u trajtuan: Dëmi material dhe jo material sipas LMD-së, përgjegjësia për shpërblimin e dëmit material dhe jo material si dhe kriteret për përcaktimin e lartësisë së dëmit material dhe jo material. Ndërsa në pjesën e dytë u trajtuan: Mënyra e të provuarit në procedurën e shpërblimit të dëmit material dhe jo material dhe praktika për caktimin e lartësisë së shpërblimit të dëmit material dhe jo material.

Në fillim të trajnimit u potencua se numri i madh i kontesteve gjyqësore për shpërblimin e dëmit, qoftë të dëmit material apo jo material, praktika gjyqësore jo e harmonizuar sa i përket vendosjes dhe kriterëve për përcaktimin e lartësisë së dëmit jo material, janë tregues që imponojnë trajtimin e gjithanshëm të kësaj tematike.

Në vazhdim u potencua se mbrojtja juridiko civile e të mirave dhe ekzistimi i përgjegjësive juridike civile, është segment i rëndësishëm në kuadër të sigurimit të një niveli më të lartë të mbrojtjes së të mirave njerëzore të mbrojtura juridikisht. Përcaktimi i saktë i përgjegjësive së shkaktarit të dëmit dhe të realizimit të drejtës së palës së dëmtuar në shpërblimin e dëmit në

marrëdhëniet juridike civile jo-kontraktuale është një prej sfidave të gjyqtarëve të fushës civile.

Edhe pse praktika gjyqësore është relativisht e zhvilluar lidhur me këtë tematikë, mirëpo numri i madh i rasteve nëpër gjykatat e Republikës së Kosovës, rritja e vazhdueshme e numrit të rasteve për shpërblim e dëmit, ka ndikuar që të ketë dallime në praktikën gjyqësore veçmas sa i përket kriterëve për përcaktimin e lartësisë së dëmit material dhe jo material, por edhe mënyra e vërtetimit të gjendjes faktike në këto raste shpesh ka të meta.

Më tej u theksua se qëllimi i shpërblimit të dëmit në të drejtën tonë nëse vështrojmë dispozitat ligjore të LMD-së për shpërblimin e dëmit është detyrimi i personit përgjegjës për rivendosjen e gjendjes e cila ka qenë para se të shkaktohet dëmi. Pra, qëllim primar i shpërblimit të dëmit është rivendosja e gjendjes para shkakimit të dëmit, nëse kjo nuk është e mundur e që zakonisht është e pamundur të bëhet rikthimi i plotë i gjendjes së mëparshme, atëherë personi përgjegjës ka për detyrë që për pjesën tjetër të dëmit të japë shpërblim në të holla. LMD përparësi i ka dhënë shpërblimit të dëmit në natyrë, e pastaj shpërblimit të dëmit në të holla edhe pse në praktikën gjyqësore më shumë zbatohet shpërblimi i dëmit në të holla.

Gjatë këtij trajnimi u përdoren metodat e shpjegimit të pjesshëm teorik, duke u bazuar në raste nga praktika gjyqësore duke u shoqëruar me ushtrime, diskutime interaktive, materialit të ofruar nga trajnuesit, analizës së rasteve nga praktika e pasur gjyqësore duke zbërthyer dispozitat ligjore në fuqi që rregullojnë këtë lëmi si dhe duke sqaruar paqartësitë e përmendura më lartë.

Përfitues në këtë trajnim ishin gjyqtarët e gjykatave themelore dhe bashkëpunëtorët profesional.

Liria e shprehjes dhe informimit – Neni 10 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore

Më 20 shtator 2019, Akademia e Drejtësisë organizoj trajnimin me temë: “Liria e shprehjes dhe informimit – Neni 10 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (KEDNJ)”.

Qëllimi i këtij trajnimi është avancimi i njohurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve lidhur me lirinë e shprehjes dhe informimit, në zbërthimin e nocioneve dhe kategorive që përmban neni 10 i KEDNJ si dhe mënyrën e interpretimit që bënë Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) në Strasburg

Në ditën e parë të trajnimit u trajtuan: Liria e shprehjes në kontekstin e debatit publik dhe roli i lirisë së shprehjes dhe informacioni i disponueshëm për publikun. Në ditën e dytë u trajtuan: Rëndësia e lirisë së shprehjes dhe respekti për pushtetin gjyqësor dhe detyrimet pozitive të shtetit sipas neni 10 të KEDNJ.

Në vazhdim u potencua se synimi i këtij trajnimi është trajtimi i shprehjes së lirë për të marrë dhe dhënë informacione ose ide, shpjegimi i lirisë së shprehjes në kontekstin e debatit publik, komentet e çështjeve publike nga figura publike apo nga media.

U potencua se prej zyrtarëve publikë që shërbejnë në gjyqësor mund të pritet që ata të tregojnë përmbajtje në ushtrimin e lirisë së tyre të shprehjes në të gjitha ato raste ku autoriteti dhe paanshmëria e gjyqësorit mund të vihen në pikëpyetje.

Në trajnim u potencua se jurisprudenca e GJEDNJ nën këtë tematikë dëshmon se ndonëse gjyqësori gëzon një mbrojtje të veçantë, ai nuk funksionon në vakum, dhe pyetjet lidhur me administrimin e drejtësisë mund të jenë pjesë e debatit publik.

Në parim, shpifja ndaj një gjykatësi nga shtypi ndodh gjatë debateve për keqfunksionimin e

sistemit gjyqësor, ose në kontekstin e dyshimit të pavarësisë a të paanshmërisë së gjykatësve. Rastet e tilla janë të rëndësishme për publikun dhe nuk duhet të lihen jashtë debatit publik, sidomos në një vend që përjeton tranzicionin drejt një gjyqësori të pavarur dhe efektiv.

Me tej u potencua se publiku duhet të jetë në gjendje të marrë informacion në lidhje me aktivitetet e autoriteteve gjyqësore përmes mediave. Prandaj, gazetarët duhet të jenë në gjendje të raportojnë lirisht dhe të komentojnë funksionimin e sistemit të drejtësisë.

Lidhur me hyrjen në fuqi të Protokollit 16, të KEDNJ (1 gusht 2018) u potencua se ky Protokoll i mundëson gjykatave më të larta vendore dhe tribunaleve që të kërkojnë nga GJEDNJ opinione këshillimore në pyetje që kanë të bëjnë me interpretimin e Konventës. Opinionet këshillimore, të cilat do të jepen nga Dhoma e Madhe, do të përmbajnë arsyetime dhe nuk do të jenë detyruese.

Gjatë këtij trajnimi u përdoren metodat e shpjegimit teorik, duke u bazuar në raste studimore dhe nga praktika duke u shoqëruar me diskutime interaktive të lehtësuara nga trajnuesit, përmes analizës dhe shtjellimeve të tematikës, me fokus në zbatimin e standardeve dhe kërkesave që përmban neni 10 i KEDNJ si dhe përmes rasteve të përzgjedhura nga praktika e GJEDNJ.

Përfitues në këtë trajnim ishin gjyqtarët dhe prokurorët e të gjitha niveleve në Republikën e Kosovës dhe bashkëpunëtorët profesional.



Administrimi i provave - parimet

Më 24 shtator 2019, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme (PTV), ka realizuar trajnimin nga lemia e kundërvajtjes me temë “Administrimi i provave - parimet”

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve në lidhje me dispozitat ligjore që kanë të bëjnë identifikimin dhe trajtimin e provave në procedurën e kundërvajtëse.

Ne fokus të këtij aktiviteti trajnues ishin paraqitja e parimeve themelore për identifikimin dhe mënyrën e administrimit të provave në procedurën kundërvajtëse me theks të veçantë në

vlërësimin e drejtë të tyre, kuptimi i provës dhe faktit.

Trajnimi u zhvillua në formë të diskutimeve interaktive, ku pjesëmarrësit kishin mundësinë të paraqesin sfidat dhe vështirësitë që ballafaqohen në gjatë praktikë.

Përfitues të këtij trajnimi ishin: gjyqtarë nga niveli themelor – departamenti për kundërvajtje nga regjionet te ndryshme te Kosovës.



Forcimi i kapacitetit të Prokurorëve dhe Zyrtarëve Ligjorë të PSRK-së për të ndjekur rastet e terrorizmit

Më 24-25 shtator 2019, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me EULEX-in në kuadër të Programit të Trajnimit të Vazhdueshëm, ka realizuar trajnimin me temë “Forcimi i kapacitetit të Prokurorëve dhe Zyrtarëve Ligjorë të PSRK-së për të ndjekur rastet e terrorizmit”.



Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve që përmes diskutimeve dhe prezantimit të praktikave më të mira, si dhe përmes elaborimit të rasteve nga praktika të ngritën kapacitetet profesionale që kanë të bëjnë

me shkathtësitë në hetimin dhe luftimin e veprave penale të terrorizmit.

Ky trajnim ka trajtuar çështjet rreth veçantive dhe sfidat në ndjekjen e rasteve të terrorizmit në Kosovë duke përfshirë trajtimin e çështjeve rreth ndjekjes së rasteve të terrorizmit dhe krimeve të tjera të rënda, përgatitja e procedurës paraprake dhe mbrojtja e dëshmitarëve.

Vëmendje parësore iu kushtua fjalës hyrëse, çështjet e ligjit dhe mbledhja e dëshmive nga dëshmitarët si dhe marrja e tërthortë në pyetje e te dyshuarve, fjala përfundimtare dhe ankesat.

Për të trajtuar këtë temë janë angazhuar ekspert ndërkombëtar si dhe Prokuror nga PSRK me qëllim të ndarjes së përvojës në rastet e ndjekjes së veprave penale të terrorizmit.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë nga departamenti special, prokurorë special si dhe zyrtar ligjorë nga Prokuroria Speciale.



Zbatimi i ligjit për shtetësinë e Kosovës

Më 25 shtator 2019, Akademia e Drejtësisë me përkrahjen e Zyrës së UNHCR-it organizoj trajnimin me temë: “Zbatimi i ligjit për shtetësinë e Kosovës” në kuadër të PTV-së. Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve lidhur me zbatimin efikas të Ligjit për shtetësinë



në Republikën e Kosovës.

Në pjesën e parë të trajnimit u trajtuan: Dispozitat ligjore për shtetësinë në Republikën e Kosovës dhe mënyrat e fitimit të shtetësisë. Në pjesën e dytë u trajtuan mënyrat e humbjes së shtetësisë, afatet për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave si dhe praktika gjyqësore vendore dhe ajo në vendet e rajonit.

Në trajnim u theksua se në praktikë janë evidencuar probleme dhe paqartësi ligjore rreth mënyrave të fitimit, humbjes dhe rifitimit të shtetësisë së Republikës së Kosovës dhe çështje të tjera të ndërlidhura me shtetësinë. Gjithashtu u shtjelluan edhe disa çështje në formë pyetjesh që morën përgjigje në këtë trajnim si: dilemat që po shfaqen lidhur mënyrat e fitimit dhe humbjes së shtetësisë në Kosovë dhe problemet kryesore në zbatimin e Ligjit për Shtetësinë e Kosovës.

Në vazhdim u theksua se Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB) në një raport të saj dha alarmin për rritjen e numrit të personave pa sht-

etësi. OKB thekson se mbi 12 milion persona në të gjithë botën nuk gëzojnë të drejtën e shtetësisë nga asnjë shtet dhe rrjedhimisht privohen nga të drejtat themelore të njeriut. Ajo u bën thirrje të gjitha vendeve të ndihmojnë duke u dhënë shtetësi këtyre personave. Situata po përkeqësohet, thotë raporti i OKB-së, e si pasojë prindër pa shtetësi po lindin fëmijë pa shtetësi.

Në vijim u potencua se paraqitet si rrjedhojë e marrëdhënieve juridike administrative në rastin kur me aktin administrativ përfundimtar (vendimi) i Komisionit të Ankesave për Shtetësi, pala e pakënaqur paraqet padi, kur nuk mund të përdor mjete të rregullta juridike atëherë lind konflikti midis palës dhe organit të cilin e ka nxjerr aktin administrativ përfundimtar. Ky konflikt lind si rrjedhojë e ligjshmërisë së aktit përfundimtar me të cilin organi shtetëror vendos mbi të drejtën, detyrimin ose interesin juridik të ushtruesit të kërkesës për fitimin apo humbjen e shtetësisë.

Gjatë këtij trajnimi u përdoren metodat e shpjegimit të pjesshëm teorik, duke u bazuar në raste nga praktika gjyqësore duke u shoqëruar me ushtrime, diskutime interaktive, materialit të ofruar nga trajnuesit, analizës së rasteve studimore si dhe duke zbërthyer standardet dhe kërkesat e Konventave Ndërkombëtare dhe dispozitave ligjore në fuqi që rregullojnë këtë lëmi.

Përfitues në këtë trajnim ishin gjyqtarët e Departamentit për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore dhe Gjykatës së Apelit dhe bashkëpunëtorët profesional të Departamentit për Çështje Administrative si dhe zyrtarët e Departamentit për Shtetësi, Azil, dhe Migrim - MPB.

Trafikimi me qenie njerëzore - Sesioni II

Më 26-27 Shtator 2019, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me projektin e Organizatës Evropiane për Ligjin Publik ELPO, mbajti punëtorinë dy-ditore me temë: “Lufta kundër Trafikimit me qenie njerëzore”

Qëllimi i kësaj punëtorie ishte luftimi dhe zbatimi i drejtë i ligjit në fuqi sa i përket këtyre veprave penale.

Gjatë kësaj punëtorie janë trajtuar aspektet ligjore të Trafikimit me qenie Njerëzore, të kuptuarit e viktimës si dhe perspektivat e viktimës. Me fokus të veçantë ishte mbrojtja e viktimës para dhe gjatë zhvillimit të procesit penal, mbështetja, rehabilitimi i viktimës dhe riintegrimi i saj në shoqëri.

Me rastin e kësaj punëtorie përmes rasteve praktike u vu në pah se trafikimi me qenie njerëzore është dukuri e përhapur dhe më fitimprurëse e krimit të organizuar, duke arritur dimensione të njëjta me trafikimin e drogës dhe të armëve. Andaj, u kërkua që pjesëmarrësit të kuptojnë drejt elementet e veprës penale të trafikimit me qenie njerëzore dhe të njohin format e shfrytëzimit të viktimave të trafikimit me njerëz në mënyrë që të ketë rezultate në luftimin e këtyre veprave.

Përfitues të kësaj punëtorie ishin gjyqtarët, prokurorët, bashkëpunëtorët profesional.



Program i Specializuar Trajnimi për zhvillimin e kapaciteteve në luftën kundër korrupsionit, Sesioni II

Më 26-27 shtator 2019, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, organizoi sesionin e trajnimit me temën “Program i Specializuar Trajnimi për zhvillimin e kapaciteteve në luftën kundër korrupsionit, sesioni II”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive profesionale të gjyqtarëve, prokurorëve dhe përfituesve tjerë rreth natyrës dhe formave të korrupsionit si dhe veprave penale që janë të ndërlidhura me korrupsionin.

Gjate trajnimit u potencua luftimi i veprave penale korruptive, kuptimi i korrupsionit sipas legjislacionit penal në fuqi, pasojat e korrupsionit si dhe format e bashkëpunimit dhe koordinimit institucional të institucioneve të mandatuara për luftën kundër korrupsionit.

Po ashtu gjatë trajnimit u elaboruan instrumentet vendore dhe ndërkombëtare në luftë kundër korrupsionit, dilemat dhe vështirësitë e të provuarit të veprave të natyrës korruptive si dhe masat për parandalimin dhe ekspozimin ndaj korrupsionit zyrtarë.

Trajnimi u zhvillua në formë të diskutimeve interaktive, ku pjesëmarrësit kishin mundësinë të paraqesin sfidat dhe vështirësitë që ballafaqohen në praktikë.

Përfitues të trajnimit ishin gjyqtarë nga Gjykata e Apelit, gjyqtarë, prokurorë dhe bashkëpunëtor profesional të nivelit themelor të regjioneve të ndryshme të Kosovës.



Aktivitetet nga Programi i Trajnimit Fillestar

Aktivitetet e realizuara në kuadër të trajnimit fillestar për gjyqtarët e sapo emëruar (gjenerata e VII)

Në vazhden e zbatimit të programit trajnues, gjatë muajit shtator gjyqtarët e sapo emëruar (gjenerata e VII), në trajnimin fillestar kanë realizuar 16 sesione trajnuese, prej tyre 7 sesione trajnuese janë realizuar nga moduli: "Shkathtësitë personale dhe ndërdisiplinare" 9 sesione nga moduli: "Rendi Juridik Kombëtar dhe Ndërkombëtar".

Nga nën moduli: "Etika profesionale" janë realizuar 6 (gjashtë) sesione trajnuese ku u trajtuan: pavarësia – përmbajtja dhe vlera juridike e parimit të pavarësisë – influenca e ushtruar nga ekzekutivi dhe legjislativi, paanshmëria – përmbajtja dhe vlera juridike e këtij parimi dhe konflikti i interesave – keqpërdorimi i funksionit gjyqësor dhe prokurorial.

Në kuadër të nën modulit: "Rregullat e komunikimit është realizuar 1 (një) sesion trajnues përmes të cilit gjyqtarët patën rastin të përfitojnë njohuri të reja nga: Rregullat e komunikimit të jashtëm dhe përvojat më të mira në mjedisin e punës.

Gjatë kësaj periudhe nga nën modulit: "KEDNJ" janë realizuar 8 (tetë) sesione

trajnuese, ku u shtjelluan: Këshilli i Evropës, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut duke u shpjeguar përmes neneve përkatëse.

Gjithashtu në përmbushje të trajnimit teorik, në këtë periudhë është realizuar edhe 1 (një) sesion trajnuese nga nën-moduli: " E drejta Kushtetuese" ku gjyqtarët patën rastin të njoftohen më gjerësisht me rolin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës – procedura dhe vendimet.

Në periudhën raportuese në kuadër të trajnimit praktik në institucione jo gjyqësore gjyqtarët e sapo emëruar kanë realizuar vizitë në Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe Agjencinë kundër Korrupsion.

Ndërsa komponenta e trajnimit praktik, për këtë periudhë është realizuar përmes vijimit të praktikës nga ana e gjyqtarëve të sapoemëruar në gjykatat përkatëse konform orarit të përcaktuar me program. Trajnimin fillestar për gjyqtarët e sapo emëruar janë duke e ndjekur (39) gjyqtarë të sapo emëruar, shtatë (7) prej të cilëve janë të komunitetit serb.



Aktivitetet e realizuara në kuadër të trajnimit fillestar për prokurorët e sapo emëruar (gjenerata e VIII)

Sipas plan programit të përcaktuar me programin trajnues për prokurorët e sapo emëruar (gjenerata e VIII), ka vazhduar me realizimin e aktiviteteve të planifikuara edhe gjatë muajit shtator. Në këtë periudhë janë realizuar gjithsej 18 (tetëmbëdhjetë) sesione trajnuese nga Moduli : “Kodi i Procedurës Penale”.

Nga nën moduli: “Aktakuza procedura e shqyrtimit” janë realizuar 9 (nëntë) sesione trajnuese ku u trajtuan: elementet e domosdoshme të aktakuzës, ngritja e aktakuzës, të drejtat e të pandehurit pas pranimit të aktakuzës si dhe ndryshimi, zgjerimi dhe huthja e aktakuzës.

Në kuadër të nën modulit: “Fillimi i hetimit formal dhe procedura penale” janë realizuar 7 (shtatë) sesione trajnuese ku prokurorët e sapoemëruar patën mundësinë ti zgjerojnë njohurit rreth procedurave paraprake-

parashtrimi i kallëzimit penal, fillimi dhe kohëzgjatja e hetimeve si dhe masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit.

Gjatë realizimit të nën modulit: “Shmania nga ndjekja penale” janë realizuar 2 (sesione) sesione trajnuese ku u shtjelluan: Shmangia nga ndjekja penale sipas KPPK-së dhe pezullimi i hetimit sipas KPPK-së.

Po ashtu në kuadër të trajnimit praktik në institucione jo gjyqësore prokurorët e sapo emëruar gjatë muajit shtator kanë realizuar vizitë në Shërbimin Korrektues të Kosovës, dhe Agjencinë Kundër Korrupsion.

Gjatë kësaj periudhe janë realizuar 10 ditë trajnim praktik në prokurori konform orarit të përcaktuar.



Vizitë e gjyqtarëve dhe prokurorëve të sapo emëruar në Burgun e Sigurisë së Lartë

Me datë 04 shtator 2019 Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me Shërbimin Korrektues të Kosovës, organizoi vizitë në “Burgun e Sigurisë së Lartë” në Dyz, në të cilën kanë marrë pjesë



gjyqtarët e sapo emëruar (gjenerata e VII) dhe prokurorët e sapo emëruar (gjenerata VIII).

Qëllimi i kësaj vizite, ishte që gjyqtarët dhe prokurorët e sapo emëruar të njoftohen me rolin, punën, funksionimin dhe kushtet e Burgut të Sigurisë së Lartë.

Në kuadër të kësaj vizite, gjyqtarët dhe prokurorët u pritën nga Drejtori i Burgut i cili e bëri prezantimin lidhur me organizimin dhe funksionimin e Burgut të Sigurisë së Lartë, si dhe menaxhimin e të burgosurve, kushtet e tyre, sistemin e sigurisë, si dhe të shohin më nga afër formën e trajtimit mjekësor për të burgosurit.

Po ashtu, gjyqtarët dhe prokurorët patën mundësi të vizitojnë objektin, si dhe të njihen edhe me hapësirat ku të burgosurit zhvillojnë aktivitete sportive, sallat e rekreacionit dhe bibliotekës, si dhe u njoftuan rreth kapacitetit të këtij burgu për mbajtjen e të burgosurve, kategorizimin, mënyrën e realizimit të vizitave si dhe aspekte tjera që lidhen drejtpërdrejt me punën e gjyqtarëve dhe prokurorëve.



Trajnim praktik i gjyqtarëve dhe prokurorëve të sapo emëruar në Agjencinë Kundër Korrupsion

Më 25 shtator 2019, Akademia e Drejtësisë, në kuadër të Programit të Trajnimit Fillestar për gjyqtarët dhe prokurorët e sapo emëruar, ka trajnimin praktik në Agjencinë Kundër Korrupsion.



Qëllimi i këtij trajnimi ishte që gjyqtarët dhe prokurorët e sapo emëruar të njoftohen me rolin, funksionin detyrat dhe përgjegjësitë e këtij institucioni.

Me rastin e këtij trajnimi u potencua roli i AAK në luftimin dhe parandalimin e korrupsionit, kallëzimet penale të institucionet përkatëse, si Prokuroria e Shtetit, Policia e Kosovës, rastet e përcjella sipas strukturës së veprave penale, zhvillimi i hetimeve, pushimi i hetimeve, dhe hedhja poshtë e rasteve.

Po ashtu, u trajtuan konflikti i interesit ku me theks të veçantë u diskutua mbi deklarin dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave, llojet e deklarin të pasurisë, deklarin me marrjen e detyrës së zyrtarëve të lartë publik, kontrolli i deklarin të pasurisë, si dhe parandalimi i konfliktit të interesit.

Trajnimi u realizua përmes shpjegimeve teorike dhe diskutimeve interaktive, me ç ‘rast gjyqtarët dhe prokurorët e sapo emëruar patën rastin të bëjnë pyetje të ndryshme për çështjet që ishin në fokus të trajnimit



Aktivitetet nga Programi për Hulumtime dhe Publikime

Takimi i Këshillit të Redaksisë së Revistave të Akademisë së Drejtësisë

Prishtinë, më 02 shtator 2019, në Akademinë e Drejtësisë është zhvilluar takimi i parë i Këshillit të Redaksisë së revistave “Opinio Juris” dhe “Justicia” të Akademisë së Drejtësisë.

Znj. Luljetë Hetemi, U.D. Drejtor i Akademisë së Drejtësisë bazuar në vendimin e Këshillit Drejtues të datës 31 maj 2019, njoftoi anëtarët e Këshillit të Redaksisë me mandatin e këtij Këshilli si dhe të drejtat dhe përgjegjësitë me rastin e nxjerrjes së revistave “Opinio Juris” dhe “Justicia” të Akademisë së Drejtësisë. Më tej i njoftoj anëtarët se transformimi i IGJK-së në Akademi ka shtruar nevojën e rishikimit të Rregullores për Hulumtime dhe Publikime të ish Institutit Gjyqësor të Kosovës si dhe në formimin e organeve të reja duke përfshirë edhe përbërjen e Këshillit të Redaksisë.

Me rastin e këtij takimi, vëmendje të veçantë gjatë diskutimeve iu kushtua Standardeve të Publikimeve, të nxjerra nga Drejtori Ekzekutiv i AD-së, të cilat do të jenë bazë për mënyrën e vlerësimit të punimeve dhe çështje të tjera që kanë të bëjnë me punën e këtij organi. Më tej

nga anëtarët e Këshillit të Redaksisë u diskutua veçanërisht për motivimin e komunitetit ligjor për punime hulumtuese në revistën “Opinio Juris” me qëllim të rritjes së cilësisë dhe rritjes së punimeve në këtë revistë. Përveç kësaj u theksuan edhe probleme tjera që kanë të bëjnë me mungesën e impaktit ndërkombëtar të kësaj reviste prandaj edhe fokusi i këtij organi (Këshillit të Redaksisë) do të jetë në senzibilizimin e kësaj çështje fillimisht, e më pastaj në publikimin e saj.

Meqenëse revista “Justicia” e gjyqtarëve dhe prokurorëve të sapo emëruar, që kanë përfunduar Programin e Trajnimit Fillestar është e pa publikuar për shkak të mos konsolidimit të Këshillit të Redaksisë, të gjithë njëzëri u pajtuan që të bëjnë vlerësimin e punimeve që kaheerë janë dërguar nga ata, e më pastaj të merren me punimet e radhës për revistën “Justicia” të gjyqtarëve dhe prokurorëve të sapo emëruar që aktualisht janë duke e ndjekur trajnimin fillestar në Akademi të Drejtësisë.



Takimi i Këshillit të Redaksisë së Revistave të Akademisë së Drejtësisë

Prishtinë, më 18 shtator 2019, në Akademinë e Drejtësisë është zhvilluar takimi i radhës së Këshillit të Redaksisë së revistave të Akademisë së Drejtësisë.

Qëllimi i këtij takimi ishte shqyrtimi i punimeve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të sapo emëruar të gjeneratës të cilët e kanë përfunduar Programin e Trajnimit Fillestar dhe ndarja e punimeve për vlerësim për publikim në revistën “Justicia”

Këshilli i Redaksisë gjatë shqyrtimit të punimeve identifikoj 54 punime të gjyqtarëve dhe 22 punime të prokurorëve dhe i klasifikoj sipas fu-

shave. Më tej gjatë shqyrtimit të punimeve vendosi të kërkoj nga autorët që të reduktojnë punimet e tyre maksimum në 15 faqe për të vazhduar më tutje.

Në fund të takimit anëtarët e Këshillit të Redaksisë së Revistave të Akademisë së Drejtësisë u pajtuan që sapo të kenë punimet e reduktuara nga autorët në një afat sa më të shkurtër të bëjnë vlerësimin e punimeve dhe të bëhet publikimi i punimeve të përzgjedhura në revistën “Justicia”.



Ceremonia e publikimit të Doracakut: Praktika e Gjykatës së Apelit e fokusuar në lëndët që kthehen në rishqyrtim

Me 23 shtator Akademia e Drejtësisë, në bashkëpunim me Programin e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) realizojë ceremoninë e publikimit të Doracakut: "Praktika e Gjykatës së Apelit e fokusuar në lëndët të cilat



kthehen në rigjykim".

Doracaku paraqet një hulumtim të praktikës së Gjykatës së Apelit, për divizionin civil, departamentin për çështje administrative dhe departamentin për çështje ekonomike. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit në koordinim me Akademinë e Drejtësisë kanë bërë identifikimin e shkeljeve më të shpeshta në praktikë, duke ofruar zgjidhje përmes praktikës së Gjykatës së Apelit. Doracaku përmban edhe udhëzime adekuate për veprimet procedurale që duhet ndërmarrë, për të zvogëluar trendin e lëndëve që kthehen në rishqyrtim si dhe për të ndikuar në rritjen e efikasitetit në zgjidhjen e rasteve gjyqësore.

Të pranishmëve në këtë ceremoni iu drejtuan me fjalë rasti znj. Luljetë Hetemi, U.D Ekzekutiv në Akademinë e Drejtësisë, në emër të Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) znj. Znj. Marta Gazideda, Menagjer i Portfolios për Qeverisje të mirë/ zëvendës Koordinatore e Programit, kryetari i Gjykatës Supreme, z. Enver Peci, si dhe nga Këshilli Gjyqësor znj. Makifete Saliuka.

Në emër të autorëve të këtij doracaku, të pranishmëve në këtë ceremoni iu drejtuan z. Hasan Shala, kryetar i Gjykatës së Apelit, dhe z. Albert Zogaj, gjyqtarë në Gjykatën e Apelit.

Znj. Luljetë Hetemi në mes tjerash theksoi se ky botim do të shërbejë si udhërrëfyes në procesin e bërjes së drejtësisë dhe njëkohësisht si mjet dhe burim shtesë për zhvillimin profesional të gjyqtarëve.

Znj. Marta Gazideda, në fjalën e saj potencoj gatishmërinë e shtetit Norvegjez për të ofruar ndihmë për Kosovën dhe institucionet e saj dhe në këtë rast përmes projektit të UNDP edhe



printimin e këtij doracaku.

znj. Makifete Saliuka, duke theksuar rëndësinë e këtij doracaku falënderoi pa përjashtim të gjithë kontribuuesit, ndërkaq kryetari i Gjykatës Su-



preme, z. Enver Peci në mes tjerash tha që doracaku është një vlerë që do të jetë lehtësues për gjithë gjyqtarët pa marrë parasysh nivelin



dhe falënderoi Akademinë dhe UNDP duke përfshirë edhe gjyqtarët e Gjykatës së Apelit për krijimin e tij.

Në emër të autorëve të këtij botimi, z. Hasan Shala dhe z. Albert Zogaj njëzëri theksuan se ky doracak do të jetë ndihmesë veçanërisht për gjyqtarët e Gjykatave Themelore dhe zbatimin e udhëzimeve të tij do të ndikoj në zvogëlimin e lëndëve të kthyer në rigjykim. Më tej ata në fjalët e tyre shprehën falënderim të veçantë për Akademinë dhe UNDP të cilët kanë mundësuar hartimin e këtij doracaku duke shpresuar që të mos mbetet me qaq meqenëse siç u shprehën ata

priten ndryshimet legjislative siç është Kodi civil dhe kjo pa diskutim që do të ketë nevojë për të pasur komantar dhe burime tjera sikurse ky doracak.

Në këtë ceremoni morën pjesë, kryetar të gjykatave, gjyqtarë nga gjitha nivelet, gjyqtarë nga gjitha nivelet veçanërisht nga divizioni civil, departamenti administrativ dhe ekonomik, përfaqësues të UNDP-së si dhe nga Akademia e Drejtësisë

Aktivitetet për profesionet e tjera ligjore

Kodi Penal dhe Kodi i procedurës penale

Me 17 dhe 18 shtator 2019, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme (PTV) me përkrahje nga OPDAT i Departamentit Ligjor të SHBA-së realizoi dy trajnime një-ditore lidhur me Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale në Republikën e Kosovës, për zyrtarë të Policisë së Kosovës.



Qëllimi i këtyre trajnimeve ishte zgjerimi i njohurive të përfituesve lidhur me ndryshimet në Kodin Penal të Kosovës, si dhe ndryshimet e pritshme në Kodin e Procedurës Penale, sidomos për aspektet që ndikojnë në punën e policisë si ekzekutues të sundimit të ligjit.

Trajnimet u fokusuan në ndryshimet legjislative në KPK, veprat e reja penale që janë inkuadruar me këto ndryshime, si dhe ndikimet e të gjitha këtyre në punën e përditshme të njësive relevante të policisë dhe në bashkëpunimin në linjën polici-prokurori-avokat-gjykatë.

Me rastin e këtyre trajnimeve u trajtuan: Fillimi i procedurës penale për veprat penale kundër pasurisë; vjedhja e identitetit dhe pajisja e

qasjes; kurdisja e ndeshjes ose e sportit; keqtrajtimi i kafshëve dhe ndotja e ushqimit dhe e ujit të shtazëve; ndërtimi pa leje; rrezikimi i trafikut publik dhe ngasja në gjendje të paaftë apo të dehur.

Këshilla dhe udhëzime u dhanë edhe nga këndvështrimi i mbrojtjes lidhur me: Kualifikimet e mbrojtësit; Mbrojtësi me shpenzime publike, kur mbrojtja nuk është e detyruar; Të drejtat e të dëmtuarit ose viktimës dhe Marrja në pyetje nga policia.

Më tutje u vazhdua me: Mbledhjen e informatave dhe provave nga policia (veprimet fillestare të policisë dhe Autorizimet e policisë); Kallëzimi penal i policisë; Hedhja e kallëzimit penal; Masat e veçanta hetimore – me theks të veçantë nënë që trajtojnë autorizimet e policisë; Fillimi i procedurës penale me fazën e hetimit formal apo ngritjen e aktakuzës; Aktvendimi për fillimin e hetimit; Identifikimi i personave apo sendeve; Afati i hetimeve, Pushimi dhe Rihapja e hetimeve; si dhe Marrja në pyetje para ngritjes së aktakuzës.

Trajnimet u realizuan në formë të prezantimeve si dhe diskutimeve interaktive mes pjesëmarrësve dhe trajnuesve lidhur me situatat konkrete në punën e tyre.

Përfitues ishin kryesisht hetues dhe zyrtarë policor nga rajone të ndryshme të Policisë së Kosovës.

Barazia gjinore në procedurë gjyqësore dhe në rastet e dhunës në familje në veçanti si dhe në çështjet familjare-pasuria e përbashkët e bashkëshortëve

Më 20 shtator 2019 Akademia e Drejtësisë në kuadër të aktiviteteve për profesionet e lira, me kërkesën e Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas në mbështetje të GIZ-it, ka realizuar trajnimin me temë: “Barazia gjinore në procedurë gjyqësore dhe në rastet e dhunës në familje në veçanti, Barazia gjinore në çështjet familjare-pasuria e përbashkët e bashkëshortëve”

Qëllimi i këtij trajnimi ishte zbatimi i drejtë i dispozitave ligjore të Ligjit mbi dhunën në familje si dhe barazinë gjinore dhe krijimi i praktikave më të mira në ofrimin e ndihmës juridike në çështje e dhunës në familje dhe barazinë gjinore nga ana e zyrtarëve të ndihmës juridike falas.

Gjatë këtij trajnimi janë trajtuar çështjet si në vijim: Dhuna në familje dhe forma e shfaqjes së

saj në fokus gjinorë dhe urdhri për mbrojtje, Kushti për caktimin e urdhrin për mbrojtje si dhe masat për parandalimin e urdhrin, Barazia gjinore në çështjet familjare dhe Pasuria e veçantë dhe e përbashkët e bashkëshortëve.

Në këtë trajnim janë diskutuar raste nga praktika e zyrtarëve të ndihmës juridike falas me ç ‘rast janë adresuar çështjet me theks të veçantë të kësaj natyre, veçanërisht kontributi në krijimin e pasurisë së përbashkët dhe pjesëtimi i pasurisë së përbashkët. Lidhur me këtë është udhëzuar se si palët mund të hartojnë të drejtën e tyre ligjore.

Përfitues në këtë trajnim ishin 18 zyrtarët e Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas nga gjitha regjionet.



Barazia gjinore në kontestet për të drejtën e trashëgimisë dhe në kontestet nga marrëdhënia e punës

Më 21 shtator 2019 Akademia e Drejtësisë në kuadër të aktiviteteve për profesionet e lira, me kërkesën e Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas në mbështetje të GIZ-it , ka realizuar trajnimin me temë: “Barazia gjinore në kontestet për të drejtën e trashëgimisë dhe në kontestet nga marrëdhënia e punës”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte zbatimi i drejtë i dispozitave ligjore të Ligjit për trashëgiminë dhe krijimi i praktikave më të mira në ofrimin e ndihmës juridike në çështje trashëgimore dhe në kontestet nga marrëdhënia e punës nga ana e zyrtarëve të ndihmës juridike falas.

Gjatë këtij trajnimi janë shtjelluar temat si në vijim: Mos deklarimi i trashëgimtarëve dhe procedura pas shpalljes së trashëgimisë, Diskriminimi në të drejtën e trashëgimisë në

forma tjera si cenimi për së gjalli apo edhe ndarja faktike, Diskriminimi në punë, mënyra e shfaqjes së diskriminimit mbi baza gjinore, si dhe Mbrojta gjyqësore në rastet e diskriminimit mbi baza gjinore.

Në këtë trajnim janë diskutuar raste nga praktika e zyrtarëve të ndihmës juridike falas me ç ‘rast janë adresuar çështjet problematike dhe më komplekse të kësaj natyre, veçanërisht trashëgimtarët që nuk përfshihen në masën trashëgimore. Lidhur me këtë është udhëzuar se si palët mund të realizojnë të drejtën e tyre përmes padisë.

Përfitues në këtë trajnim ishin 18 zyrtarët e Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas nga gjitha regionet.



Aktivitetet tjera

Trajnimi i Trajnuesve-Shkrimi dhe arsyetimi ligjor

Më 16 shtator 2019, Akademia e Drejtësisë me përkrahjen e USAID-it organizoj trajnimin për trajnues me temë: “Shkrimi dhe arsyetimi ligjor”. Ligjërues në këtë trajnim ishte gjyqtari z. Russell F. Canan, ekspert nga USAID-i.



Qëllimi i këtij trajnimi ishte ngritja e kapaciteteve të trajnuesve gjyqësor në fushën e shkrimit dhe arsyetimit ligjor.

Në pjesën e parë të trajnimit u trajtuan: Shqyrtimi i materialeve (sillabusi, shabllonet (penal dhe civil), shqyrtimi i metodologjive (ligjëratë/prezantim-poëer point, dialog interaktiv, hipotetiket dhe ushtrimet e shkrimit, kuiz) si dhe diskutimi i përmirësimeve të mundshme.

Në pjesën e dytë u trajtuan faza e para-shkrimit, diskutimi i kërkesave të publikimit, diskutimi i përdorimit të aktgjykimeve me gojë, diskutimi i përdorimit të profesorëve të gramatikës dhe shkrimit.

Në vazhdim të trajnimit u theksua se janë tre parime themelore gjatë procesit të hartimit paraprak; Rritja e efikasitetit, promovimi i qasjes dhe i qartësisë dhe sigurimi i korrektësisë. Gjithashtu u vu në pah se hartimi paraprak është procesi dhe metodologjia për kryerjen e hulumtimeve ligjore, organizimin e evidencave dhe skicimin gjatë përgatitjes për nxjerrjen e aktgjykimit të shëndoshë me shkrim ose me gojë. Hulumtimi paraprak ligjor ndihmon të identifikohen faktet relevante.

Per metodën ÇRAK - IRAC-anglisht (Çështja, Rregulli, Analiza dhe Konkluzioni) u potencua se përbëhet prej elementeve themelore të përmendura të analizës ligjore. Është proces nëpërmjet të cilit të gjithë juristët mendojnë rreth çdo problemi ligjor. Nëpërmjet zbatimit të kësaj formule reduktohet kompleksiteti i ligjit në një ekuacion të thjeshtë. Kjo metodë është e dobishme sepse i jep lexuesit të aktgjykimit një kuptim fillestar të çështjes, dhe e tregon rrugëtimin e ndjekur për analizën e bërë nga gjykata.

Në vazhdim u potencua se aktgjykimin me shkrim ose me gojë të “shëndoshë” e bëjnë tre parime: transparenca, me kohë-afatshmëria dhe besueshmëria.

Në këtë trajnim u potencua se shkrimi i mirë ligjor karakterizohet me saktësinë-të ketë bazë solide ligjore, analitik-të mos jetë thjesht deklarim apo rishikim i fakteve dhe opinioneve, i organizuar-të ketë rregull në paraqitjen e tij-titujt, i plotë-të mbulojë të gjitha aspektet, specifik dhe konkret-jo me dykuptime, logjik-të ketë strukturë dhe organizim, korrekt-gramatikë e mirë, shenja pikësimi, bindës-ta bëjë lexuesin ta besojë shkrimin dhe i qartë-i lehtë për t’u kuptuar.

Gjatë këtij trajnimi u përdor dhe u aplikua një metodologji interaktive e cila përbëhej nga metodat e shpjegimit të pjesshëm teorik, raste nga praktika gjyqësore, diskutime interaktive, analizës të rasteve studimore, duke zbërthyer dhe trajtuar edhe raste të tjera hipotetike.

Përfitues në këtë trajnim ishin trajnuesit gjyqësor të Akademisë së Drejtësisë që ligjërojnë në këtë lëndë në programet e Akademisë së Drejtësisë.

Vazhdon bashkëpunimi i mirë AD – KGJK - Nënshkruhet Memorandumi i Mirëkuptimit mes KGJK-së dhe AD-së

Prishtinë, 19 shtator 2019, znj. Luljetë Hetemi – U.D. e Drejtorit Ekzekutiv dhe znj. Valmira Pefqeli- U.D. e Koordinatorit të Programit në Akademinë e Drejtësisë kanë zhvilluar një takim të përbashkët me z. Skender Çoçaj – Kryesuesin e KGJK-së.

Qëllimi i këtij takimi ishte bashkëpunimi i KGJK-së dhe AD-së në interes të ngritjes së kapaciteteve profesionale të gjyqtarëve dhe sistemit gjyqësor në përgjithësi, si dhe nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet dy institucioneve për të fuqizuar edhe më tutje bashkëpunimin ndërinstitucional në sferën e shkëmbimit të informatave në çështjet e fushëveprimit të përbashkët.

Gjatë këtij takimi përves nënshkrimit të Memorandumit të Mirëkuptimit mes dy palëve u diskutua edhe për procesin e planeve të trajnimeve, në veçanti për Programin e Trajnimeve Fillestare për gjyqtarët e sapo emëruar e gjithashtu edhe për Programin e Trajnimeve të Vazhdueshme ku si referencë ishin ndryshimet legislative.

Në fund të takimit bashkëbiseduesit u pajtuan që të vazhdoj koordinimi dhe bashkëpunimi reciprok për funksionimin më të mirë dhe më cilësor të programeve trajnuese dhe shërbimeve tjera që ofron Akademia e Drejtësisë.



Takimi i Këshillit Programor të Akademisë së Drejtësisë

Më 23 shtator 2019, në Akademinë e Drejtësisë është mbajtur takimi i radhës i Këshillit Programor të AD-së.

Temë kryesore e diskutimit në këtë takim ishte diskutimi i Raportit të Komisionit për Shqyrtimin e Aplikacioneve për Trajnues dhe propozimi për trajnuesit e përkohshëm të AD-së për Këshillin Drejtues.

Me rastin e këtij takimi anëtarët e Këshillit Programor shqyrtuan Raportin e Komisionit dhe dosjet e pranuar të secilit kandidatë për trajnues në afatin e kompletimit të dokumenteve shtesë. Bazuar në të gjeturat pas përmbylljes së

afatit të kompletimit të dokumentacionit, Këshilli Programor unanimisht u pajtuan që ti drejtohen me një mendim Këshillit Drejtues të Akademisë lidhur me listën e trajnuesve të përkohshëm të AD-së.

Gjatë këtij takimi, anëtarët e Këshillit Programor diskutuan edhe tema të tjera të rëndësishme për Akademinë e Drejtësisë e të cilat bien në kompetencën e Këshillit Programor.



Takim me përfaqësues të projektit Regjional Anti-Korrupsion

Më 24 shtator 2019, znj. Luljetë Hetemi, U.D. e Drejtorit të Akademisë së Drejtësisë, ka pritur në takim znj. Desislava Gotskova Menaxhere e projektit regjional “Antikorrupsion” që implementohet nga AIRE CENTRE dhe RAI dhe i mbështetur nga Qeveria Britanike dhe znj. Ganimete Ismaili, në cilësinë e koordinatorit nacional në këtë projekt.



Ky takim u realizua në kuadër të vazhdimit të bashkëpunimit ndërmjet Akademisë së

Drejtësisë dhe Sekretariatit të këtij projekti i cili është i fokusuar në gjashtë (6) shtete të Ballkanit Perendimor) për Anti-Korrupsion me qëllim të fuqizimit të bashkëpunimit ndërkombëtar në procesin e kthimit të aseteve në përputhje me praktikat më të mira.

Me rastin e këtij takimi z. Gotovska ofroj për Akademinë e Drejtësisë ekzemplarë nga “Doracaku për kthimin efektiv të aseteve në përputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare” si dhe “Mjetet dhe praktikat më të mira në bashkëpunimin ndërkombëtar për rikuperimin e aseteve”

Të dy palët siguruan që bashkëpunimi do të vazhdojë edhe më tutje në interes të fuqizimit të kapaciteteve profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve në këtë fushë.



Takimi i Këshillit Drejtues të Akademisë

Me datë 26 shtator 2019, në Akademinë e Drejtësisë, u mbajt takimi i nëntëmbëdhjetë me radhë i Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë, i udhëhequr nga Kryesuesi i Këshillit Drejtues z. Aleksandër Lumezi, Kryeprokuror i Shtetit.

Qëllimi i këtij takimi ishte shqyrtimi i Raportit final të rekomandimit nga Komisioni Rekrutues për pozitën e Drejtorit Ekzekutiv të AD-së dhe zgjedhja e drejtorit të ri si dhe diskutimi dhe vendosja për çështje të ndryshme në kuadër të fushëveprimit dhe mandatit të Akademisë.

Sipas agjendës së përcaktuar për këtë takim, fillimisht anëtarët e Këshillit Drejtues miratuan procesverbalet nga dy takimet e kaluara. Më pas Këshilli Drejtues sipas agjendës vazhdoi me procedurën për zgjedhjen e Drejtorit. Me rastin e votimit për tre kandidatët e rekomanduar nga Komisioni Rekrutues për të cilët u realizua me votim të fshehtë për secilin, rezultoi që asnjëri nuk fitoi votat e shumicës. Lidhur me këtë Këshilli Drejtues vendosi anulimin e këtij

konkursi dhe shpalljen e konkursit të ri.

Në vazhdim Këshilli Drejtues diskutoi për mendimin e Këshillit Programor për listën e trajnuesve të dalë nga dy shpalljet për trajnues që ka pasur Akademia e Drejtësisë dhe miratoi njëzëri.

Për gjatë këtij takimi Këshilli Drejtues vendosi edhe për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit për përbërjen e Këshillit të Redaksisë meqë një nga anëtarët e këtij organi ka dhënë dorëheqje për shkaqe shëndetësore. Më tej u aprovua edhe mendimi i Këshillit Gjyqësor për njohjen e provimit përfundimtar të dy gjyqtareve të gjeneratës së VI të cilat pjesën e mbetur të programit janë duke e vijuar në gjeneratën e VII të gjyqtarëve të sapo emëruar.

Në fund të takimit u diskutuan edhe çështje të tjera të rëndësishme në kuadër të fushëveprimit dhe mandatit të Akademisë.



Punëtorja për hartimin e modulit: Etika Profesionale

Me 27-28 shtator 2019, Akademia e Drejtësisë në mbështetje të GIZ, Projekti për Reformë Ligjore dhe Administrative, ka realizuar punëtorinë për hartimin e modulit trajnues me temë “Etika Profesionale”.

Qëllimi i punëtorisë ishte hartimi dhe finalizimi i modulit trajnues për Etiken Profesionale, i cili do të shërbejë gjatë trajnimeve të obligueshme të gjyqtarëve për këtë fushë.

Gjatë punëtorisë është diskutuar për përmbajtjen që duhet të ketë ky modul dhe nën modulet tjera

duke u pajtuar që fokusi të jetë në: pjesë nga kodi i etikës, përgjegjësia, shkeljet dhe masat disiplinore si dhe procedura disiplinore.

Në vazhdim trajnuesit hartuan përmbajtjen mbi këto baza duke marrë në konsideratë edhe shembuj nga praktika gjyqësore si dhe u pajtuar që me rastin e trajnimeve për etiken të fokusohen kryesisht në raste praktike..

Pjesëmarrës në këtë punëtori ishin, trajnuesit e Akademisë së Drejtësisë që janë angazhuar në hartimin e këtij moduli, staf i SKGJK (ish ZPD), përfaqësues nga Akademia e Drejtësisë si



<https://ad.rks-gov.net>

**Adresa “Lagjja e Spitalit”
Rr. Muharrem Fejza p.n
Prishtinë, Republika e Kosovës**

**Tel: + 381 38 200 18 660
Fax: + 381 38 512 095
E-mail: infoad@rks-gov.net**